



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1646/7 Prot.

Tiranë, më 30/12 /2020

VENDIM

Nr. 30 datë 30.12.2020

PËR

MIRATIMIN E TARIFAVE TË REGJISTRIMIT DHE TARIFAVE VJETORE TË SHKOLLIMIT PËR PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË “BACHELOR”, TË CIKLIT TË DYTË “MASTER PROFESIONAL” DHE “MASTER I SHKENCAVE”, SI DHE PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË ME KOHË TË PLOTË, PËR VITIN AKADEMIK 2020 - 2021, NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 3, gërma ç, Vendimin nr. 288, datë 21.05.2018 të Këshillit të Ministrave, ndryshuar me VKM nr. 778, datë 26.12.2018, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 26, pika 3, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 të Bordit të Administrimit “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe Vendimin e Senatit Akademik nr.16, datë 03.12.2020, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë tarifën e regjistrimit për programet e studimit në Universitetin Politeknik të Tiranës për vitin akademik 2020 – 2021, sipas tabelës nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të miratojë tarifën vjetore të shkollimit për programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor”, programet e studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave” si dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, për vitin akademik 2020 – 2021 sipas tabelave nr. 2, 3 dhe 4 bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Tarifa e shkollimit paguhet nga studentët në masën, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi.

4. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi. Studenti i cilësuar në bazë të rregullores së institucionit si përsëritës, i nënshtrohet tarifës vjetore të shkollimit të vitit akademik në të cilin vazhdon studimet.
5. Studenti i regjistruar në një program të ciklit të parë ose në një program të integruar të studimeve, i cili nuk i ka shlyer të gjitha detyrimet (jo financiare), të parashikuara në programin përkatës të studimit brenda kohëzgjatjes normale të tij (3 vjet cikli i parë dhe 5 vjet studimet e integruara), do të paguajë vetëm për provimet që do të japë për lëndët e mbartura gjatë vitit akademik 2020 – 2021.
6. Studenti i regjistruar në një program të ciklit të dytë i cili nuk i ka shlyer të gjitha detyrimet (jo financiare), të parashikuara në programin përkatës të studimit brenda kohëzgjatjes normale të studimit (Master Profesional dhe Master i Shkencave), do të paguajë vetëm për provimet që do të japë për lëndët e mbartura gjatë vitit akademik 2020 – 2021.
7. Pagesa e tarifës së shkollimit për ciklin e parë të studimeve dhe programin e integruar të studimeve, si rregull kryhet përpara fillimit të sezonit të provimeve të semestrit të parë. Përrjashtimisht në kushtet e pandemisë të shkaktuar nga Covid – 19 apo situata të tjera objektive që e bëjnë të pamundur respektimin e këtij rregulli, njësitë kryesore të kenë mundësi veprimi për metodologjinë dhe afatet e pagesave.
8. Pagesa e tarifës së shkollimit për ciklin e dytë të studimeve, si rregull kryhet e ndarë në 2 (dy) këste. Kësti i parë paguhet në përfundim të semestrit të parë dhe kësti i dytë përpara sezonit të provimeve të semestrit të dytë. Përrjashtimisht në kushtet e pandemisë të shkaktuar nga Covid – 19 apo situata të tjera objektive që e bëjnë të pamundur respektimin e këtij rregulli, njësitë kryesore të kenë mundësi veprimi për metodologjinë dhe afatet e pagesave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETARI

ARBEN DHIMA

